



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË ADMINISTRATËS TATIMORE TË KOSOVËS PËR VITIN 2022

Raporti i nënshkruar nga

Vlora Spanca,

Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, qershor 2023

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Administratës Tatimore të Kosovës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Administratës Tatimore të Kosovës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Administratës Tatimore të Kosovës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

A1 ATK në 29 raste kishte vonesa në trajtimin e kërkesave të tatim paguesve për kthim /rimbursim tatimor mbrenda afatit ligjor.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Theksimi i Çështjes

1 ATK edhe gjatë vitit 2022 nuk kishte vënë në funksion sistemin e-pasuria, por që pasuritë jokapitale dhe stoqet janë të evidentuara në regjistër të brendshëm(Excel). Përmes procedurave të auditimit është konstatuar që vlera e pasurisë nën 1,000€ dhe stoqeve ishte e saktë dhe e plotë dhe ishte prezantuar drejt në PFV. Pas përpjekjeve të bëra nga ana e ATK-së migrimi i pasurive në sistemin e-pasuria kishte filluar gjatë vitit 2023.

Opinionin e auditimit nuk është modifikuar për shkak të kësaj çështje.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Administratës Tatimore të Kosovës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Administratës Tatimore të Kosovës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Administratës Tatimore të Kosovës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin

e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Administratës Tatimore të Kosovës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Administratës Tatimore të Kosovës.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Në vitin 2022, Administrata Tatimore e Kosovës ka arkëtuar rreth 21% të hyra më shumë krahasuar me vitin paraprak. Në kontekst të gjetjeve vërehet vonesë në shqyrtimin e kërkesave të tatimpaguesve për kthim/rimbursim tatimor. Çështjet tjera të identifikuara kanë të bëjnë me mos fiskalizimin e plotë të bizneseve dhe menaxhim jo efikas i llogarive të arkëtueshme/ borgjeve të vjetra.

Ky raport ka rezultuar me katër (4) rekomandime, prej të cilave dy (2) janë rekomandime të reja, një (1) pjesërisht i përsëritur dhe një (1) i përsëritur. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Vonesë në shqyrtimin e kërkesave për kthim/rimbursim tatimor

Gjetja

Neni 30 i ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat, obligon ATK-në që brenda 60 ditëve të shqyrtoj dhe aprovoj kërkesën nga tatim paguesit për kthim/rimbursim tatimor. Nëse kërkesa për kthim/rimbursim është aprovuar nga ATK mirëpo është tejkaluar afati ligjor, atëherë duhet të paguhet edhe interes tatim paguesve për vonesa.

Nga testimet dhe analiza e bazës së kthimeve/rimbursimeve, identifikua 29 raste ku ATK nuk i kishte shqyrtuar kërkesat e tatim paguesve për kthim/rimbursim tatimor brenda afatit ligjor. Këto vonesa ishin nga 1 deri në 63 ditë kalendarike përtej afatit ligjor. Për këto vonesa, ATK nuk kishte aplikuar edhe pagesën e interesit ndaj tatim paguesve.

Kjo kishte ndodhur për shkak të vonesave të trajtimit të kërkesave sipas prioriteteve nga ana e departamentit përkatës.

Ndikimi

Vonesat në kthime/rimbursime tatimore, ju shkaktojnë bizneseve vështirësi financiare në ushtrimin e aktiviteteve të tyre operative dhe në anën tjetër rrisin rrezikun e padive të tatim paguesve ndaj ATK-së si pasojë e mos pagesës së interesit.

Rekomandimi A1

Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj menaxhim efikas në procesin e kthimeve/rimbursimeve, në mënyrë që kërkesat për rimbursim të shqyrtohen brenda afatit të përcaktuar ligjor. Në rastet e vonesave nga ATK duhet të aplikohet pagesa e interesit për tatim paguesit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Të hyrat

Administrata Tatimore e Kosovës për vitin 2022 ka realizuar të hyra neto prej 659,192,945€. Këto të hyra kanë të bëjnë me të hyrat tatimore (tatimi në vlerën e shtuar, tatimi në të ardhurat personale, tatimi i mbajtur në burim dhe tatimi në të ardhurat e korporatave), si dhe të hyrat jo tatimore (nga shitja e pasurive, të hyrat nga viti i kaluar, etj.).

Çështja B1 - Fiskalizimi jo i plotë i bizneseve me arka fiskale

Gjetja

UA nr. 02/2018 për shfrytëzimin e pajisjeve elektronike dhe sistemeve fiskale neni 4, pika 1.1, specifikon se të gjithë personat që bëjnë furnizime të mallrave dhe/ose shërbimeve në objektet, njësitë ose vendet të cilat mund të jenë në qasje të publikut, janë të obliguar që të shfrytëzojnë pajisjet elektronike fiskale (PEF) dhe pajisjet tjera të obligueshme për regjistrimin dhe vërtetimin e furnizimit të mallrave dhe shërbimeve. Më tutje, neni 4, pika 3, sqaron se personi të cilit i referohet obligimi i përcaktuar me paragrafin 2 të këtij neni dhe i cili njëkohësisht kryen edhe aktivitete që nuk janë të përjashtuara ose të liruara nga detyrimi i regjistrimit përmes arkës fiskale dhe të transferimit të të dhënave përmes terminalit të serveri i ATK-së, në kuptim të paragrafit 1 të këtij neni, do të jetë i obliguar që çdo qarkullim individual gjatë kryerjes së këtyre aktiviteteve të regjistrojë përmes arkës fiskale si dhe t'i transferojë të dhënat përmes terminalit në server të ATK-së.

Ne kemi vërejtur që përkundër përpjekjeve të bëra nga ATK fiskalizimi i plotë i të gjitha bizneseve mbetet ende sfidë. Numri i bizneseve që nuk janë fiskalizuar ende e që sipas legjislacionit në fuqi kërkohet të pajisen me arka fiskale në fund të vitit 2022 ishte 12,537 tatim pagues. Pjesën më të madhe prej 8,974 bizneseve pa arka fiskale e përbënin mikro bizneset me qarkullim vjetor deri në 5,000€. Në raport me vitin e kaluar kemi një ulje të numrit të tatim paguesve që janë pa arka fiskale (në 2021 numri i tatim paguesve që nuk kishin arka fiskale ishte 13,656).

Sipas ATK-së mosfunksionalizimi i plotë i bizneseve me arka fiskale është rezistenca e vazhdueshme e bizneseve për shkak të kostos së pajisjeve, mirëpo edhe problemeve tjera gjatë procesit të funksionalizimit të sistemit të ri për arka fiskale.

Ndikimi

Mos pajisja e tatim paguesve me arka fiskale e rrit rrezikun për mungesën e informatave gjatë veprimtarive ekonomike si dhe mundësinë e evazionit tatimor. Gjithashtu, kjo rezulton me një konkurrencë jo të barabartë ndërmjet bizneseve që zhvillojnë aktivitete ekonomike.

Rekomandimi B1 Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se të gjitha bizneset të cilat i plotësojnë kriteret për fiskalizim do të pajisjen me pajisjet elektronike fiskale (PEF) sipas kërkesave ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Të arkëtueshmet

ATK në PFV-të e vitit 2022 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 476,225,869€, me një rritje prej 42,271,631€ krahasuar me vitin e kaluar. Prej tyre 238,083,251€ apo 50% janë tatim bazë, 96,271,617€ apo 20%, janë ndëshkime dhe 141,871,001€ apo 30% janë shpenzime të interesit. Bazuar në llojin e tatimit, pjesëmarrjen më të madhe në totalin e llogarive të arkëtueshme e kanë: tatimi mbi vlerën e shtuar, tatimi në korporata, kontributet pensionale, tatimi për bizneset individuale, tatimi në paga etj. Nga ekzaminimet tona kemi vërejtur çështjen në vijim:

Çështja C1 - Menaxhimi i llogarive të arkëtueshme/ borxheve të vjetra

Gjetja

ATK për vitin 2022 në planin e punës kishte përcaktuar që të inkasohen borxhet në vlerë 160,832,685€. Po ashtu, në planin punës ishte paraparë ndërmarrja e iniciativave për të pastruar stokun e borxhit nga të gjitha borxhet e pa mbledhshme.

ATK kishte bërë një progres në mbledhjen e llogarive të arkëtueshme (borxheve të reja). Kjo vërehet nga fakti që në vitin 2022 ishin mbledhur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 155,273,103€, apo 97% nga ajo që ishte planifikuar (në vitin 2021 kjo ishte 92%). Po ashtu, edhe për nga vlera e mbledhur kishte një rritje prej 16% krahasuar me vitin paraprak pasi që në vitin 2021 ishin mbledhur 133,934,715€.

Megithatë, ATK nuk ka treguar efikasitet në mbledhjen e borxheve të vjetra apo në marrjen e ndonjë iniciative për të pastruar stokun e borxhit nga të gjitha borxhet e pa mbledhshme. Kjo çështje mbetet sfidë edhe për të ardhmen pasi që vlera e tij në fund të vitit 2022 kishte arritur në 115,472,121€, krahasuar me vlerën e tij në 2021 që ishte 96,140,956€. Rritja prej 19,331,165€ vjen nga aplikimi ndëshkimeve dhe interesit që aplikohen në sistem.

Rritja e stokut të borxhit të vjetër është një sfidë e vazhdueshme e cila është kryesisht e ndikuar nga pushimi i aktivitetit të operimit të bizneseve.

Ndikimi

Niveli i ulët i arkëtimit të borxheve të vjetra rritë stokun e borxheve të akumuluar, të cilat me kalimin e kohës shndërrohen në borxhe të pambledhshme.

Rekomandimi C1

Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime më efektive në inkasimin e këtyre borxheve. Për më tepër, përpjekje shtesë nevojiten në trajtimin e stokut të borxheve të vjetra bazuar në kërkesat ligjore përkatëse.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.3 Detyrimet kontigjente

Në PFV janë shpalosur detyrimet kontigjente për paditë e ushtruara ndaj ATK-së. Një pjesë e këtyre padive është nga tatim paguesit për pagesën e tatimeve, ndërkaq pjesën më të madhe e përfshijnë paditë nga stafi i ATK-së. Sipas listës janë 834 padi aktive, por të cilat nuk kanë vlerë të përafërt financiare.

Çështja A2 - Mangësi në prezantimin e detyrimeve kontigjente

Gjetja Rregullorja nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiar, neni 18, kërkon që Organizatat Buxhetore duhet të raportojnë të gjitha detyrimet kontigjente.

ATK në PFV kishte bërë shpalosjen e plotë të listës së padive, sipas shënimeve të marra nga gjykata themelore, duke prezantuar të gjitha informatat e tyre, por pa vlerë financiare. Një numër i padive kishin të bënin me kontestet e tatim paguesve, kurse numrin më të madh të tyre e përbënte padia për kompensim të shujtave ditore dhe pagave jubilarë nga stafi i ATK-së.

Sipas zyrtarëve të ATK-së, kjo kishte ndodhur për arsye se paditë e tatim paguesve ishin të pabazuara dhe ishte vlerësuar se gjasat që ATK të ketë dalje të parasë janë shumë të ulëta. Kjo sepse ATK i ka shqyrtuar në disa nivele ankesat e tatim paguesve (shpalosja e listës ishte bërë për qëllime të transparencës). Përderisa te paditë e ushtruara nga stafi në lidhje me shujtat, ATK nuk kishte bërë ndonjë vlerësim.

Ndikimi Vlerësimi jo i plotë i detyrimeve kontingjente sipas vlerës financiare ndikon që PFV-të të mos prezantojnë gjendjen e duhur.

Rekomandimi A2 Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj për aq sa është e mundshme, të bëhet një matje dhe vlerësim financiar për detyrimet kontingjente dhe këto të prezantohen me vlerë financiare në PFV e vitit 2023.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
Burimet e fondeve	13,257,788	11,275,725	10,942,799	12,574,959	12,782,571
Grante Qeveritare – Buxheti	13,257,788	11,275,725	10,942,799	12,574,959	12,655,956
Te hyrat nga AKP-ja	0	0	0	0	126,615

Buxheti final është më i ulët se buxheti fillestar për 1,982,063€. Kjo ulje është si rezultat i reduktimit të buxhetit me rishikim dhe ndryshimeve buxhetore me vendime të Qeverisë.

Në vitin 2022, ATK ka shpenzuar 97% të buxhetit final ose 10,942,798€ me një ulje prej 2% në krahasim me vitin 2021. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	13,257,788	11,275,725	10,942,799	12,574,959	12,782,571
Pagat dhe mëditjet	7,732,579	7,732,579	7,716,938	7,678,023	7,748,931
Mallrat dhe shërbimet	2,963,513	2,823,513	2,747,180	2,245,966	2,057,739
Komunalitë	361,696	361,696	144,555	147,066	134,626
Subvencionet dhe transferet	0	40,000	17,139	10,316	0
Investimet Kapitale	2,200,000	317,937	316,987	2,493,587	2,841,275

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë si në vijim:

- Buxheti final në kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte realizuar pothuajse 100%. Nuk kishte pasur ndryshim të buxhetit fillestar me atë final për këtë kategori;
- Buxheti final për kategorinë mallrave dhe shërbimeve (përfshirë komunalitë) ishte realizuar 91%. Në raport me buxhetin fillestar kategoria e mallrave dhe shërbimeve ishte zvogëluar për 140,000€ (Në prill, ATK me vendim kishte transferuar 40,000€ nga mallrat dhe shërbimet në subvencione dhe transfere, kurse në fund të vitit me vendimin e Qeverisë të datës 13/12/2022, është bërë shkurtim i buxhetit nga kjo kategori për 100,000€);
- Buxheti final për kategorinë subvencione dhe transfere ishte realizuar 43%. Subvencionet dhe transferet në ATK përdoren kryesisht për përkrahjen e zyrtarëve të brendshëm të cilët kanë humbur anëtarët e familjes; dhe
- Buxheti final për kategorinë e investimeve kapitale ishte më i ulët se ai fillestar për 1,882,063€. Ky reduktim i buxhetit bazohet në vendimet e Qeverisë. Me buxhetin fillestar ishin planifikuar shtatë (7) projekte, prej të cilave katër (4) nuk kishin filluar fare. Shkaktarët që projektet ishin reduktuar nga buxheti fillestar kishin të bënin me faktin që ATK nuk kishte bërë përgatitjet planifikuese me kohë për realizimin e tyre. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte 100%.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2022



Të hyrat tatimore të planifikuara nga Qeveria e Kosovës me Ligjin nr. 08/L-066 mbi ndarjet buxhetore për vitin 2022 ishin 680,400,000€. Ndërkaq, me Ligjin e rishikuar të buxhetit nr. 08/L-143, vlera e parashikuar e të hyrave tatimore ishte rritur në 711,600,000€. ATK kishte arritur të realizonte 723,863,985€, ndërsa në vlera neto, realizimi ishte 659,192,945€, (të hyrat bruto 723,863,985€ -64,671,040€ kthimet). Krahasuar me vitin e kaluar, të hyrat bruto në përgjithësi kanë pësuar rritje. Në vitin 2022, realizimi i të hyrave bruto ishte më i lartë për 126,229,454€ apo rreth 21% më shumë se në vitin 2021.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Pranimet	2021 Pranimet	2020 Pranimet
Të hyrat bruto	680,400,000	711,600,000	723,863,985	597,702,804	467,039,833
Kthimet	-53,000,000	-55,800,000	-64,671,040	-56,069,995	-31,344,054
Të hyrat neto	627,400,000	655,800,000	659,192,945	541,632,809	435,695,779

Tabela 4. Të hyrat/pranimet e realizuara dhe kthimet sipas kategorive ekonomike në tri vitet e fundit (në €)

Përshkrimi	2022 Pranimet	2021 Pranimet	2020 Pranimet
TATIMI I PARAGJYKUAR	238,566	202,189	43,894
TATIMI MBI VLERËN E SHTUAR	344,621,146	291,494,508	222,381,488
TVSH - JA E SHTYRË	3,100	174,816	117,476
TAX NË PAGA-MBAJTUR NË BURIM	145,289,408	129,285,474	111,849,166
TATIMI PËR BIZNESE INDIVIDUALE	40,339,167	33,715,593	26,331,442
TATIMI MBI QIRANË E PASURISË SË PATRUPËZUAR	448,457	813,997	390,349
TAT. I MBAJTUR NË BURIM INTERES TE DREJTA PRONËSORË QIRA	29,483,064	25,706,003	19,394,896
TATIMI PËR KORPORATA	159,635,531	113,743,401	85,235,491
KONTO KALUESE - ADMINISTRATA TATIMORE	4,181	16,402	29,999
TE HYRAT NGA GJOBAT E ATK-ËS	3,768,749	2,423,816	1,264,043
TË HYRAT - SHITJA E MBETURINAVE	0	76,312	72
TË HYRAT SHITJA E MALLRAVE TE KONFISKUAR	10,115	29,293	1,476

REGJISTRIMI I PENGUT	0	0	40
TË HYRAT NGA VITI I KALUAR	22,500	21,001	0
Totali i pranimeve bruto:	723,863,985	597,702,804	467,039,833
KTHIMI I TVSH-ËS	-62,853,458	-53,005,138	-30,325,348
KTHIM-TAX NË PAGA-MBAJTUR NË BURIM	-254,596	-243,725	-348,815
KTHIM - TATIMI PËR BIZNESE	-302,637	-109,971	-105,078
KTHIM - QIRA FITIM LOTO DREJT	-19,085	-349	-49,090
KTHIM - TATIM PËR KORPORATA	-1,237,264	-2,707,062	-513,722
KTHIM - TE HYRAT - GJOBAT E ATK-ËS	-4,000	-3,750	-2,000
Totali i kthimeve:	-64,671,040	-56,069,995	-31,344,054
Totali i pranimeve neto (pranimet bruto – kthimet):	659,192,945	541,632,809	435,695,779

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2021 ka rezultuar me tri (3) rekomandime. ATK kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2022, një (1) rekomandim ishte zbatuar, një (1) pjesërisht i zbatuar dhe një (1) nuk ishte zbatuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 5 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 5 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2021	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Të hyrat	.Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se të gjitha bizneset të cilat i plotësojnë kriteret për fiskalizim do të pajisen me pajisjet elektronike fiskale (PEF) sipas kërkesave ligjore.	Numri i bizneseve që nuk janë fiskalizuar, ishte pothuajse i njëjtë me vitin 2021.	Nuk është adresuar
2.	Llogaritë e arkëtueshme	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime më efektive në inkasimin e këtyre borxheve. Për më tepër, përpjekje shtesë nevojiten në trajtimin e stokut të borxheve të vjetra bazuar në kërkesat ligjore përkatëse.	Përkundër përpjekjeve në mbledhjen e borxheve, vlera e stokut të borxheve të vjetra dhe të pa mbledhshme mbetet ende e lartë.	Pjesërisht i zbatuar
3.	Auditimi i Brendshëm	Drejtori i Përgjithshëm në koordinim me Ministrin e Financave duhet të sigurojnë zgjidhje efektive në mënyrë që detyrat të ushtrohen në përputhje me vendimet/aktemerimet për të cilën janë emëruar zyrtarët brenda ATK-së.	Përmes funksionalizimit të Rregullores së Brendshme për strukturimin e stafit, ATK kishte arritur të adresoj këtë rekomandim.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Emine Fazliu, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Faruk Rrahmani, Drejtor i Auditimit



Edona Abazi, Udhëheqëse e ekipit



Arta Kryeziu, Anëtare e ekipit



Antigona Çitaku, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

 Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo Ministria e Financave, Punëve të Transfereve dhe Ministrisë së Financës, Rada i Transfereve Ministry of Finance, Labour and Transfers Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo		
DATË/A:	Nr. Fakte: 02/06/2023 Data: 02/06/23	
REFERENC-Ë:	QËRSHOR 2023 PRISHTINË	
PËR/ZA/TO:	Zyrën e Kombëtare të Auditimit	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Ilir Murtezaj – Drejtor i Përgjithshëm në ATK-së	
NGA/OD/FROM:	Hamit Mulaj – Drejtor i Departamentit për Shërbime të Përgjithshme në ATK-së	
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Letër konfirmimi për pranimin e draft raportit të Auditimit të Pasqyrave Financiare të ATK-se për vitin 2022	

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, ju konfirmojmë se:

Administrata Tatimore e Kosovës ka pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare për vitin 2022 me datën 25.05.2023 .

Bazuar në gjendjen e paraqitur në draft raport shihet se qasja e ekipit të Auditimit ka qenë profesionale dhe ka trajtuar të gjitha çështjet në mënyre parimore duke analizuar të gjitha aktivitetet ATK-së, si dhe prezantimin e tyre në Pasqyrat Financiare të vitit 2022.

Lidhur më të gjeturat e prezantuara në draft raport pajtohem, me përjashtim të vlerësimit të rastit të fiskalizimi i bizneseve ku potencohet si rekomandim i pa zbatuar, ne mendojmë se ky është një proces i vazhdueshme dhe për kundër përpjekjeve tona të vazhdueshme për përmbushjen e këtij rekomandimi, ky është një proces i vazhdueshëm që asnjëherë nuk mund të realizohet i tëri dhe ne pa mundësi të realizimit 100 %, mendojmë se vlerësimi duhet të jetë rekomandim në vijim sepse gjithmonë bëjmë përpjekje që të realizohet, kjo shihet edhe në draft raport ku është evidentuar progresi i arritur në krahasim më vitin paraprak.

Pa mundësia e realizimit 100% rrjedh si rezultat se ky është proces kompleks, sepse vazhdimisht kemi biznese të reja dhe ato që shuhen dhe natyra e realizimit varet edhe nga shumë faktorë të cilët na bëjnë të pamundur realizimin e plotë për kundër angazhimit tonë.

Ju njoftojmë, se brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzojmë një planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(ve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri.

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit:

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.